



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 895 / Prot
27

Tiranë, më 02 05 2025

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit

QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCAVE MJEKËSORE

Tiranë

Në mbështetje të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", të ndryshuar, neni 14 germa "c" dhe "c/1" dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të ndryshuar, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, bashkëngjitur ju dërgojmë Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në institucionin tuaj.

Gjithashtu, bazuar në nenin 12/d, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar, "Plani i Veprimit" për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit, të miratohet nga titullari i institucionit dhe të dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, **jo më vonë se 20 ditë pune** nga njohja me Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas formatit të sugjeruar nga ana jonë.

Bashkëngjitur:

- Plani i Veprimit
- Aneksi 1, Përmbledhëse e Rekomandimeve

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI

Jorgji Qerami



Rekomandimet	Renditja sipas nivelit	Referenca e paragrafit në raport	Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
<p><i>Sistemi i pagave</i></p> <p>1. I përpzencat të harrohen të ndara për stafin e organikës së miratuar dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme.</p> <p>Për stafin e organikës të harrohet sipas sektorëve dhe dhertimeve referuar strukturës së miratuar, duke pasur parasysh nënshtetimet nga eprori direkt, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe titullari i institucionit.</p> <p>Për punonjësit me kontratë të përkohshme të harrohet sipas sektorëve apo shërbimeve për të cilët janë kontraktuar, duke pasur parasysh nënshtetimet nga eprori direkt, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe titullari i institucionit.</p> <p>Për stafin e autoambulancave prezenca në punë të masqarimit sipas ditëve dhe shërbimit të kryer, siç është vepruar për mjekët dhe infermierët.</p>	I lartë	Pika IV.1 Gjetje nr. 1 Fq.8-12		Menjherë dhe në vazhdim	
<p>2. Liste prezencat në çdo rast, të shoqërohen me grafikët e shërbimit sëbashku me ndryshimet (nëse do të kerë).</p> <p>3. Ndarshja listëprezencat dhe grafikët e shërbimit të jenë pjesë e dokumentacionit justifikues të listë pagesave.</p> <p>4. Objektet paragesë situatën e krijuar pranë drejtorive përkatëse përgjegjëse për burimet njerëzore, buxhetin dhe çështjet mundëse në MSHMS për të saktësuar elementët shtesë në pagë për mjekët infermierët dhe shoferët e autoambulancave të cilët kryejnë shërbim urgjence paraspitalore, ose për të bërë negociatat e duhura në vendimin e pagave.</p> <p>5. Një listë shërbim të kryhet dhe për mjekët dhe infermierët pjesë e Ndarshja të Njësisë së Koordinimit, pasi nga ana e tyre kryhet</p>	I lartë	Pika IV.1 Gjetje nr. 1 Fq.12-16		Menjherë dhe në vazhdim	

4	<p>shërbim me sistem 12-orë.</p> <p>Për shoferët e autoambulancave, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore, të fillojë procedurat siç parashikohet në pikën 10 të VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, për rishikimin e shtesës mbi pagë për shkallën e vështirësisë dhe të dëmshmërisë.</p> <p><i>Ky rekomandim vlen edhe për punonjësit e tjerë mbështetës,</i> pasi kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin kanë ndryshuar që në vitin 2022 (trajtuar me referenca ligjore në paragrafët më lart).</p> <p>Për këtë, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore duhet të ketë parasysh periudhën kur janë kryer miratimet e procedurave dhe ndryshimet e kriterëve në dispozitat ligjore.</p>	I lartë	Pika IV.1 Gjetje nr. 4 Fq.16-18	Menjëherë
---	--	---------	---------------------------------------	-----------

Plani i Veprimit hartohet në tre kopje, prej të cilave një kopje i dërgohet Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, një kopje ruhet në protokoll dhe një kopje ruhet në dosjen e auditimit.

Grupi i auditimit

Mimoza Kambo

Zogulla Koto

RAPORT PËR TUNDIM TARR

PËR AUDITIMIN E TËRËTË QENDRËN KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE TIRANË

I Përmbledhje ekzekutive

Subjekt i vlerësimit është veprimtaria e Qendrës Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë, për shërbimin e urgjencës.

Ky vlerësim u bazua në Ligjin Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 454, datë 26.08.2024 (shkresë nr. 3615 prot.), “Për verifikimin e elementëve të pagës për punonjësit e shërbimit të urgjencës paraspitalore” dhe në Programin e Angazhimit të Auditimit miratuar me shkresë nr. 3615/5 prot., datë 25.09.2024.

Objekti i auditimit:

- Auditimi i sistemit të pagave për shërbimin e urgjencës paraspitalore, nga muaji Janar 2023 deri në muajin Korrik 2024, për të vlerësuar saktësinë e përcaktimit të elementëve të pagës në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Gjetjet dhe konkluzionet

Sistemi i pagave

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë (QKUM) funksionon sipas strukturës së miratuar me Vendim të KM nr. 185, datë 4.4.2019 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 933, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës organizative të QKUM-së”, të ndryshuar; gjithsej 86 punonjës.

Me Vendim të KM çdo vit është miratuar numri i punonjësve me kontratë të përkohshme. Për vitin 2023 dhe 2024 janë miratuar 49 punonjës me kontratë të përkohshme; konkretisht VKM nr. 56, datë 1.2.2023 dhe VKM nr. 39, datë 24.01.2024.

Për periudhën objekt auditimi QKUM ka mbuluar shërbimin e urgjencës paraspitalore. Ky shërbim është kryer nga punonjës me kontratë të përkohshme, emërtesa dhe numri i të cilëve është miratuar me Vendim të KM (45 punonjës), stafi mjekë dhe infermier pjesë e Sektorit të Njësisë së Koordinimit të Urgjencave (43 punonjës), dhe shoferët e administratës (3 punonjës); gjithsej 91 punonjës.

Në Ligjin nr. 147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, janë përcaktuar qartë përgjegjësitë e QKUM-së.

Në kuptim të nenit 5 dhe 7 të këtij ligji, shërbimi i urgjencës organizohet dhe ofrohet në nivel parësor dhe spitalor. Por siç e cituam dhe në paragrafin më lart, për mbulimin e shërbimit të urgjencës paraspitalore emërtesa dhe numri i punonjësve është miratuar çdo vit me Vendim të KM. Kjo situatë është konstatuar dhe trajtuar në auditimin e fundit të realizuar në këtë institucion viti 2021. Në përfundim të raportimit është lënë rekomandimi përkatës i cili në raportimin për vitin 2021 rezultoi me status “Në proces zbatimi”.

Sa më lart vazhdon e njëjta situatë, gjë e cila ka ndikuar dhe në trajtimin financiar të punonjësve të përfshirë në kryerjen e këtij shërbimi pasi në vendimet e pagave shtesat për këto kategori janë parashikuar vetëm në nivel parësor dhe spitalor.

Nga auditimi, rezultoi:

- Të dhënat e pasqyruara në listëprezencë nuk japin siguri për saktësinë dhe plotësinë e tyre. Në asnjë rast grafikët e shërbimit nuk janë bashkëlidhur listëprezencës dhe listëpagesës.

Në vendimet e KM për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, koha mesatare ditore

punonjerve mbështetur dhe punonjësit e tjerë të specialitetit të ndryshëm në detyra të detyrueshme të administratës publike të ndryshme për ushtrimin e shërbimit mjekësor për situatën e emergjencës dhe të detyrueshme.

Për rekomandimet dhe edhe për punonjësit e tjerë mbështetur parafillore të ndarjes së punëve sipas shkallës së veshtimisë dhe detyrueshme për shëndetin kanë ndryshuar që në vitin 2022 (trajtuar me referenca ligjore në paragrafët më lart).

Për këtë, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore duhet të ketë parasysh periudhën kur janë kryer miratimet e procedurave dhe ndryshimet e kriterëve në dispozitat ligjore.

H. Hyrje

Në bazë të Ligjit Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar; Manualin e Auditimit të Brendshëm, i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar; Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 454, datë 26.08.2024 (shkresë nr. 3615 prot.) “Për verifikimin e elementëve të pagës për punonjësit e shërbimit të urgjencës paraspitalore”; grupi i auditimit, sipas Programit të Angazhimit të Auditimit miratuar me shkresë nr 3615/5 prot., datë 25.09.2024, kreu auditim në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore Tiranë.

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë funksionon sipas strukturës së miratuar me Vendim të KM nr. 185, datë 4.4.2019 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 933, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore”, të ndryshuar; gjithsej 86 punonjës.

Me Vendim të KM çdo vit është miratuar numri i punonjësve me kontratë të përkohshme. Për vitin 2023 dhe 2024 janë miratuar 49 punonjës me kontratë të përkohshme; konkretisht VKM nr. 56, datë 1.2.2023 dhe VKM nr. 39, datë 24.01.2024.

Periudha e auditimit:	01.01.2023 – 31.07.2024
Afati i auditimit:	02.10.2024 – 03.10.2024
Grupi i auditimit:	Mimoza Kambo Zogulla Koto Isli Merxhushi
Qëllimi i auditimit:	Vlerësimi i elementëve të pagës për punonjësit e shërbimit të urgjencës paraspitalore në sistemin shëndetësor, me qëllim përcaktimin e nivelit të pagës në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
Projekt Raporti	Mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga auditimi është hartuar Projekt Raport Auditimi, vënë në dispozicion të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore Tiranë me shkresë nr. 3615/49 prot., datë 10.01.2025. Me shkresë të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore Tiranë nr. 33/1 prot., datë 24.02.2025 dhe protokolluar me tonën nr. 895/4 prot., datë 28.02.2025 është kthyer përgjigje për rekomandimet e lëna në Projekt Raport Auditimin. Referuar kësaj shkrese rezultojnë se rekomandimet e lëna në Projekt Raport Auditimi janë pranuar dhe

QKUM ka marrë masat në zbatimin e tërësor të shërbimit të urgjencës dhe bashkiakëve në bashkëpunim me bashkitë dhe spitalet Universitare, Rajonale dhe Bashkiake të Tiranës.

Në zbatim të Vendimit të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore Tiranë për miratimin e Planit të Veprimit të Auditimit të Sistemit të Pagave në bashkëpunim me bashkitë dhe spitalet Universitare, Rajonale dhe Bashkiake të Tiranës.

III. Metoda e Auditimit

Bazuar në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 454, datë 26.08.2024 (shkresë nr. 3615 prot.), dhe ndryshimet e bëra në dy vitet e fundit për pagat në sistemin shëndetësor, grupi i auditimit përgatiti programin e angazhimit të auditimit për të testuar nëse kontrollet e parashikuara veprojnë në mënyrë efektive.

Programi i Angazhimit u miratua nga drejtuesi i njësisë së AB shkresë nr. 3615/3 prot., datë 28.08.2024.

Metoda e auditimit e përdorur “Testimi hap pas hapi” dhe teknikë auditimi “Me përzgjedhje” 1 kampion për çdo pozicion pune për shërbimin e urgjencës.

IV. Gjetjet dhe konkluzionet

Pas auditimit të fushave të përcaktuara në Programin e Auditimit për sistemin e pagave, grupi i auditimit jep vlerësimet e mëposhtme:

IV.1 Sistemi i pagave

Objektivi i auditimit:

Vlerësimi nëse punonjësit e shërbimit të urgjencës paraspitalore në spitalet Universitare, Rajonale dhe Bashkiake janë paguar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Fushat të cilat u morën në konsideratë gjatë auditimit:

- Verifikimi i listë pagesave për punonjësit në shërbimin e urgjencës paraspitalore, për përllogaritjen e pagës bruto deri tek paga neto; Dokumentacioni justifikues për shtesat në pagë për personelin mjekësor dhe jo mjekësor (roje, turne, vështirësi për kushte pune, etj.);
- Efektet para dhe pas ndryshimeve të fundit në Vendimet e Këshillit të Ministrave, në fushën e pagave;
- Struktura organizative (plani dhe fakti); Vakancat dhe plotësimi i tyre për mbulimin e shërbimit;

Referuar objektit të auditimit si dhe të periudhës së audituar u përzgjedhën 4 kampionë të cilët i referohen ndryshimeve të vendimit të pagave në vitet 2023 dhe 2024. Konkretisht u përzgjedhën listë pagesat për muajin Shkurt 2023; Shtator 2023; Mars 2024; dhe Korrik 2024.

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë (QKUM) funksionon sipas strukturës së miratuar me Vendim të KM nr. 185, datë 4.4.2019 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 933, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës organizative të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore”, të ndryshuar; gjithsej 86 punonjës.

Me Vendim të KM çdo vit është miratuar numri i punonjësve me kontratë të përkohshme. Për vitin 2021 dhe 2022 janë miratuar 47 punonjës me kontratë të përkohshme. (Vendim të KM nr. 147, datë 14.03.2014 dhe VKM nr. 237, datë 06.03.2009)

Ky përbërës shërbimi shërbimi QKUM-së ka numrin shërbimi të urgjencës përcaktuar. Ky shërbim është kryer nga punonjës me kontratë të përkohshme, emërtesa dhe numri i të cilëve është miratuar me Vendim të KM (45 punonjës), stafi mjekë dhe infermier pjesë e Sektorit të Njësisë së Koordinimit të Urgjencave (43 punonjës), dhe shoferët e administratës (3 punonjës); gjithsej 91 punonjës.

Në Ligjin nr. 147/2014 "Për shërbimin e urgjencës mjekësore", janë përcaktuar qartë përgjegjësitë e QKUM-së. Në kuptim të nenit 5 të këtij ligji, shërbimi i urgjencës organizohet dhe ofrohet në nivel parësor dhe spitalor. Por siç e cituam dhe në paragrafin më lart, për mbulimin e shërbimit të urgjencës paraspitalore emërtesa dhe numri i punonjësve është miratuar çdo vit me Vendim të KM. Kjo problematikë është konstatuar dhe trajtuar në auditimin e fundit të realizuar në këtë institucion viti 2021. Në përfundim të raportimit është lënë rekomandimi përkatës, dhe konkretisht:

"Për të zgjeruar objektin e veprimtarisë lidhur me shërbimin e urgjencës, QKUM duhet të propozojë në MSHMS ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë e tij, dhe konkretisht:

-Ligji nr. 147/2014 "Për shërbimin e urgjencës mjekësore";

-VKM nr. 237, datë 06.03.2009 "Për përcaktimin e kriterëve për hapjen dhe mbylljen e spitaleve";

-Urdhër i Ministrit nr. 87, datë 02.03.2016 "Për miratimin e akteve rregullatore për funksionimin e shërbimit të urgjencës mjekësore";

-Vendim i Kryeministrit nr. 185, datë 04.04.2019 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 933, datë 29.12.2014 të KM, "Për miratimin e strukturës organizative të QKUM-së", të ndryshuar;

-Urdhër i Ministrit nr. 39, datë 25.01.2019 "Për miratimin e rregullores "për funksionimin e shërbimit të urgjencës mjekësore".

Në fund të vitit 2021 nga ana e QKUM-së është raportuar me status **"Në proces zbatimi"**.

Sa më lart vazhdon e njëjta situatë, gjë e cila ka ndikuar dhe në trajtimin financiar të punonjësve të përfshirë në kryerjen e këtij shërbimi pasi në vendimet e pagave shtesat për këto kategori janë parashikuar vetëm në nivel parësor dhe spitalor.

Nga auditimi **rezultoi:**

1. Të dhënat e pasqyruara në listëprezencë nuk japin siguri për saktësinë dhe plotësinë e tyre. Në asnjë rast grafikët e shërbimit nuk janë bashkëlidhur listëprezencës dhe listëpagesës.

Në vendimet e KM për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, koha mesatare ditore është përcaktuar 8 orë/ditë, gjë e cila nuk reflektohet në listëprezencë. Puna për këtë staf është e organizuar me sistem 12 orë.

2. Në listëprezencë nuk kuptohet se cilët mjekë dhe infermier kanë kryer shërbim në terren dhe cilët mjekë dhe infermier kanë kryer shërbim pranë Sektorit të Njësisë së Koordinimit.

Sipas listëprezencës stafit mjekë dhe infermier të cilët kryejnë shërbimin për urgjencën pranë spitaleve të përkrahura të shtesa në pagë për kryerje të shërbimit të urgjencës për ditë të shtuna dhe ditë të diel/e festa për stafin mjekë dhe infermier të cilët kryejnë shërbimin pranë spitaleve të përkrahura të shtesa në pagë për kryerje të shërbimit të urgjencës pranë spitaleve.

Kështu që në kuptim të VKM nr. 424, datë 26.6.2024, pikat 19/1/b, 19/2/b, 17/1 dhe 17/2, këto shtesa në pagë janë parashikuar për stafin mjekë dhe infermier të cilët kryejnë shërbim pranë urgjencës së spitaleve dhe jo për QKUM-në.

3. Në listëprezencë nuk referohet koha e kryerjes së shërbimit për shoferët e autoambulancave. Si pasojë e këtij veprimi deri në muajin Gusht 2024 kjo kategori është paguar si shofer administrate. Në këtë shërbim janë përfshirë dhe 3 shoferët pjesë e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.

Sipas listëprezencës shoferët e autoambulancës rezultojnë në punë gjatë ditëve të javës dhe për ditë të shtuna e të diel/e festa janë pushim. Ky post pune është me kohëzgjatje të pandërprerë, sistem 24-orësh/gatishmëri.

4. Për mjekët dhe infermierët, shtesa në pagë për kryerje të shërbimit të urgjencës paraspitalore është paguar bazuar në VKM nr. 555, datë 11.08.2011, pika 12/1/b dhe 12/2/b, shfuqizuar me VKM nr. 424, datë 26.6.2024, pika 19/1/b dhe 19/2/b.

Në fakt referuar VKM nr. 555, datë 11.08.2011 shfuqizuar me VKM nr. 424, datë 26.6.2024, ky element page është parashikuar për urgjencën e spitaleve dhe që funksionon si e tillë.

5. Shoferet e autoambulancave janë paguar si shoferë administrate, bazuar në VKM nr. 627, datë 28.9.2022, shfuqizuar me VKM nr/ 326, datë 31.05.2023, të ndryshuar, Kreu II/1, Lidhja II, klasa e IV. Shtesa në pagë për orët e natës nuk është përfituar para muajit Gusht 2024, siç parashikohet në Kodin e Punës neni 87, pavarësisht se shërbimi është kryer me sistem 12 orë.

6. Përsa i përket elementëve të tjerë të pagës, kjo kategori ka përfituar:

-Shtesë në pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin shkalla e dytë;

E njëjta kategori punonjësish për kryerje të shërbimit të urgjencës pranë spitaleve përfiton shkallën e dytë ose të parë dhe të dytë njëkohësisht, kjo në varësi të procedurave të kryera nga ana e spitaleve (trajtuar më gjerësisht në Gjetjen nr. 4).

-Shtesë për natyrë të veçantë pune parashikuar në VKM nr. 326, datë 31.5.2023, ndryshuar me VKM nr. 422, datë 26.6.2024, pika 12/m.

E njëjta kategori punonjësish për kryerje të shërbimit të urgjencës pranë spitaleve përfiton shtesë për natyrë të veçantë pune parashikuar në pikën 12/e, të VKM nr. 326, datë 31.5.2023, të ndryshuar me VKM nr. 422, datë 26.6.2024.

Në kuptim të vendimit të pagave për punonjësit mbështetës këto shtesa janë parashikuar për shoferët e autoambulancave pranë shërbimit të urgjencës në spitale.

7. Shoferët e urgjencës përfitojnë shkallën e dytë për kushte pune. Kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin kanë ndryshuar me VKM nr. 234, datë 20.4.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Lidhja III, kështu që është e nevojshme rishikimi i këtij elementi page.

Kë përfshihet prirja natyrore si më poshtë:

Titulli i gjetjes: Dokumentacioni i punës është cilësor dhe i pagësuar

Referuar Ligjit nr. 10/2010

Subjekti i audituar	Qendra Kombëtare e Gjyencës Mjekësore Franc
Subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtori i Përgjithshëm Drejtores e Financës, Investimeve dhe Buxhetit Përgjegjëse e Sektorit të Financës Përgjegjëse e Shërbimeve Mbështetëse Specialist e Burimeve Njerëzore
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 10/296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Për kampionët e përzgjedhur për auditim, listëprezencat janë bashkëlidhur listëpagesës. Listëprezenca në çdo rast është nëshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Përgjegjëse e Shërbimeve të Brendshme. Listëprezenca referon të dhëna për punonjësit e administratës, të Sektorit të Njesisë së Koordinimit dhe punonjësit me kontratë të përkohshme, mjekë, infermier dhe shoferë të autoambulancave. Postet e punës për punonjësit pjesë e Sektorit të Njesisë së Koordinimit dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme (mjekë, infermier dhe shoferë autoambulance) janë me kohëzgjatje të pandërprerë (sistem 24-orësh/gadishmëri). Në këtë listë janë të përfshirë edhe 3 shoferët pjesë e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse. Referuar listëprezencave, situata paraqitet si më poshtë: <ul style="list-style-type: none">Mjekët dhe infermierët kryejnë shërbim me sistem 12 orë. Prezenca në punë është shënuar $\frac{1}{2}$ për 12 orët e ditës dhe $\frac{3}{4}$ për 12 orët e natës.Shoferët e autoambulancave sipas listëprezencës rezultojnë në punë 8 orë në ditë gjatë javës dhe ditë të shtunë/të diel dhe festa janë pushim. Pavarësisht se në listëprezencë shënohet 8 orë gjatë ditëve të javës, shërbimi nga ana e tyre është kryer me sistem 12 orë.Grafikët e shërbimit nuk janë bashkëlidhur listëprezencave Referuar listëprezencës për muajin Shtator 2023 lidhur me orët e punës në muaj, situata paraqitet si më poshtë: Mjeku A.A ka kryer 180 orë; Mjeku D.M ka kryer 168 orë;

SHOHERËT E AUTOAMBULANCAVE

SHOHERËT E AUTOAMBULANCAVE

SHOHERËT E AUTOAMBULANCAVE

SHOHERËT E AUTOAMBULANCAVE, MËK, KQ, E D, A D dhe MËK kanë kryer nga 168 orë;

Shoferët e autoambulancave E.Xh, A.P, AL, kanë kryer 20 ditë pune ose 160 orë dhe shoferi D.M ka kryer 22 ditë pune ose 176 orë.

(Kampionët më lart janë përzgjedhur në mënyrë rastësore).

Ë njëjta situatë paraqitet edhe në listëprezencat e tjera të përzgjedhura për auditim.

Po ti referohemi Vendimeve të KM për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për mjekët, infermierët dhe shoferët e autoambulancave është parashikuar koha mesatare ditore 8 orë/ditë. Në fakt shërbimi për këtë staf është i organizuar me sistem 12 orë. Gjithashtu kontratat për këtë staf janë lidhur me afate 6-mujore referuar vendimeve të dala.

Nga auditimi **rezultoi:**

1. Të dhënat e pasqyruara në listëprezencë nuk japin siguri për saktësinë dhe plotësinë e tyre. Në asnjë rast grafikët e shërbimit nuk janë bashkëlidhur listëprezencës dhe listëpagesës.

Në vendimet e KM për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, koha mesatare ditore është përcaktuar 8 orë/ditë, gjë e cila nuk reflektohet në listëprezencë. Puna për këtë staf është e organizuar me sistem 12 orë.

2. Kohëzgjatja e punës në një muaj nuk është përmbushur sipas kërkesave të përcaktuara në Kodin e Punës, Kreu IX, kjo për stafin mjekë, infermier dhe shoferë. Në këtë rast është e nevojshme rishikimi i grafikëve të shërbimit ose analizë e burimeve njerëzore në raport me shërbimet që do të mbulojë.

3. Në listëprezencë nuk kuptohet se cilët mjekë dhe infermier kanë kryer shërbim në terren dhe cilët mjekë dhe infermier kanë kryer shërbim pranë Sektorit të Njësisë së Koordinimit.

Sipas listëpagesës stafi mjekë dhe infermier i kësaj njësie dhe punonjësit me kontratë të përkohshme ka përfituar shtesë në pagë për kryerje të shërbimit të urgjencës për ditë të zakonshme/të shtuna/ditë të diel e festa, por nuk ka përfituar shtesë në pagë për natyrë të veçantë pune.

Në kuptim të VKM nr. 424, datë 26.6.2024, pikat 19/1/b, 19/2/b, 17.1 dhe 17.2, shtesa në pagë për kryerje të shërbimit të urgjencës dhe shtesa në pagë për natyrë të veçantë pune është parashikuar për stafin mjekë dhe infermier të cilët kryejnë shërbim pranë urgjencës së spitaleve. Këto elementë page nuk janë parashikuar për QKUM-në.

4. Në listëprezencat nuk janë dhënë kopime të shërbimit nga tani e këtejmeve të autoambulancave. Si pasojë e kësaj veprimi detyrë në mënyrë të saktë 7961 të Ligjit të Punës dhe paguar si shërbim administrativ për 11 ditë për secilin ditë qëndrimi në punë dhe 3 shifra për secilin Sektor të Shërbimeve Mbështetëse.

Sipas listëprezencës shoferët e autoambulancës rezultojnë në punë gjatë ditëve të javës dhe për ditë të shtuna e të diel/e festa janë pushim. Ky post pune është me kohëzgjatje të pandërprerë, sistem 24-orësh/gatishmëri.

Kriteri:

Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në RSH”, të ndryshuar, Kreu IX;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3/ç/e; neni 22;

VKM nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavaruara dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, kreu II, pika 11.

Ndikimi/Efekti:

Listë prezencat nuk japin siguri për saktësinë e të dhënave për mungesë të evidencave mbështetëse (grafikët e shërbimit) si dhe mënyrës së paraqitjes së prezencës në punë për ditët e javës.

Përfituar ose nuk kanë përfituar shtesë në pagë sipas vendimit të pagave.

Shkaku:

Strukturat përgjegjëse për burimet njerëzore dhe për financën nuk kanë siguruar evidencë të mjaftueshme, bashkëlidhur listëpagesës.

Për shtesat në pagë nuk janë interpretuar drejtë vendimet e pagave.

Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë
Konkluzioni	<p>Në hartimin e listë pagesave nuk është siguruar evidencë e mjaftueshme, e justifikuar me grafikët e shërbimit dhe kohëshënuesin e mbajtur nga shërbimi i urgjencës.</p> <p>Pavarësisht se kjo gjetje është konstatuar dhe trajtuar për shërbimin e urgjencës, kjo vlen dhe për shërbimet e tjera të institucionit, për të siguruar evidencë të plotë dhe të saktë për prezencën në punë sipas faktit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të plotë, që do të thotë se listëprezencat duhet të shoqërohen me grafikët e shërbimit, së bashku me ndryshimet në rastet kur ka; • Të saktë, që do të thotë se mundëson kryerjen e kontrolleve nga

...nduarat përgjegjës për kohën e punës së tyre në shtëpi e nëpër
...të punës së shërbimit të urgjencës për personelin tuar

...nduarat përgjegjës për kohën e punës së tyre në shtëpi e nëpër
...të punës së shërbimit të urgjencës për personelin tuar

Shtesa në pagë nuk është vlerësuar dhe interpretuar drejtë sipas vendimit të pagave. Në disa raste janë njohur shtesat në pagë dhe në disa raste të tjera nuk janë njohur.

Në vlerësimin e auditimit, bazuar në Ligjin nr. 147/2014 "Për shërbimin e urgjencës mjekësore", neni 7, *-QKUM është institucioni përgjegjës për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore, nëpërmjet planifikimit, drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha seteve ekzistuese në një sistem mbarështetëror të unifikuar, si dhe bashkërendimin e veprimtarisë me sistemet e ngjashme në vendet fqinje*". Por, referuar vendimeve të KM për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, çdo vit janë miratuar 45 punonjës mjekë, infermier dhe shoferë të autoambulancave. Sipas informacionit të dhënë nga strukturat drejtuese të institucionit kërkesa për punonjës me kontratë i referohet kryerjes së shërbimit të urgjencës paraspitalore.

Por shtesat në pagë për QKUM-në dhe konkretisht për stafin e ngarkuar me kryerjen e shërbimit të urgjencës paraspitalore nuk është e rregulluar në vendimet e pagave.

Rekomandimi

1. Listëprezencat të hartohen të ndara për stafin e organikës së miratuar dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme.

-Për stafin e organikës të hartohet sipas sektorëve dhe shërbimeve referuar strukturës së miratuar, duke pasur parasysh nënshkrimet nga eprori direkt, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe titullari i institucionit;

-Për punonjësit me kontratë të përkohshme të hartohet sipas sektorëve apo shërbimeve për të cilët janë kontraktuar, duke pasur parasysh nënshkrimet nga eprori direkt, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe titullari i institucionit.

-Për shoferët e autoambulancave prezenca në punë të pasqyrohet sipas ditëve dhe shërbimit të kryer, siç është vepruar për mjekët dhe infermierët.

2. Listë prezencat në çdo rast, të shoqërohen me grafikët e shërbimit sëbashku me ndryshimet (nëse do të ketë).

Gjithashtu listëprezencat dhe grafikët e shërbimit të jenë pjesë e dokumentacionit justifikues të listë pagesave.

Afati i fundit për

Menjëherë dhe në vazhdim

Zbatimi
rekomandimit
Shtesa
rekomandimit

11/2024

Titulli i gjetjes: Shtesa në pagë për mjekët dhe infermierët (urgjenca paraspitalore)

Nr. i Gjetjes 2	
Subjekti i audituar	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë
Subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtori i Përgjithshëm Drejtores e Financës, Investimeve dhe Buxhetit Përgjegjëse e Sektorit të Financës
Përmbledhja e bazës ligjore	<p>Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;</p> <p>VKM nr. 466, datë 06.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 555, datë 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturën e Forcave të Armatosura”, të ndryshuar;</p> <p>VKM nr. 245, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 555, datë 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturën e Forcave të Armatosura”, shfuqizuar me;</p> <p>VKM nr. 424, datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të shtesave mbi pagë, kompesimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor në institucionet shëndetësore, në sistemin e Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.</p>
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Për periudhën objekt auditimi u përzgjedhën listëpagesat Shkurt 2023, Shtator 2023, Mars 2024 dhe Korrik 2024. Shërbimi i urgjencës paraspitalore është i organizuar me sistem 12 orë dhe kryhet nga punonjësit me kontratë të përkohshme dhe stafi i Sektorit të Njësive të koordinimit (mjekë dhe infermier).</p> <p>Nga auditimi, rezultoi: Për mjekët, shtesa në pagë për kryerje të shërbimit të urgjencës paraspitalore është paguar bazuar në VKM nr. 555, datë 11.08.2011,</p>

	<p>pika 197A të shfuqizuar me VKM nr. 424, datë 26.6.2024, pika 197A.</p> <p>Për përcaktimin e shtesës së pagës për funksionin e spitalit në të gjithë paraspitaloret është përdorur bazuar me VKM nr. 555, datë 11.08.2011, pika 1212A, shfuqizuar me VKM nr. 424, datë 26.6.2024, pika 197A.</p> <p>Në fakt referuar VKM nr. 555, datë 11.08.2011 shfuqizuar me VKM nr. 424, datë 26.6.2024, ky element page është parashikuar për urgjencën e spitaleve dhe që funksionon si e tillë</p> <p>Kriteri:</p> <p>VKM nr. 555, datë 11.8.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e Ministrisë Përgjegjëse për Shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, shfuqizuar me;</p> <p>VKM nr. 424, datë 26.6.2024 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e Ministrisë Përgjegjëse për Shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së shtetit”.</p> <p>Ndikimi/Efekti:</p> <p>Stafi mjekë dhe infermier për kryerje të shërbimit të urgjencës paraspitalore kanë përfituar shtesë në pagë si mjekët dhe infermierët e spitaleve.</p> <p>Shkaku:</p> <p>Nuk është interpretuar drejtë vendimi për pagat.</p>
<p>Vlerësimi i nivelit të riskut</p>	<p>I lartë</p>
<p>Konkluzioni</p>	<p>QKUM referuar rekomandimit të lënë nga auditimi i kryer në vitin 2021, të ndjekë me prioritet zbatimin e tij. Konkretisht rekomandimi si më poshtë:</p> <p><i>“Për të zgjeruar objektin e veprimtarisë lidhur me shërbimin e urgjencës, QKUM duhet të propozojë në MSHMS ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë e tij, dhe konkretisht:</i></p> <p><i>-Ligji nr. 147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”;</i></p> <p><i>-VKM nr. 237, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kriterëve për hapjen dhe mbylljen e spitaleve”;</i></p> <p><i>-Urdhër i Ministrit nr. 87, datë 02.03.2016 “Për miratimin e akteve</i></p>

	<p>Republika e Kosovës Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore</p> <p><i>Urdhër i Ministrit nr. 39, datë 25.01.2019 "Për miratimin e rregullores "për funksionimin e shërbimit të urgjencës mjekësore".</i></p>
Rekomandimi	<p>QKUM të paraqesë situatën e krijuar pranë drejtorive përkatëse përgjegjëse për burimet njerëzore, buxhetin dhe çështjet juridike në MSHMS për të saktësuar elementët shtesë në pagë për mjekët, infermierët dhe shoferët e autoambulancave të cilët kryejnë shërbim urgjence paraspitalore, ose për të bërë rregullimet e duhura në vendimin e pagave.</p> <p>I njëjti veprim të kryhet dhe për mjekët dhe infermierët pjesë e Sektorit të Njesisë së Koordinimit, pasi nga ana e tyre kryhet shërbim me sistem 12-orë.</p>
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	<i>Menjëherë</i>
Statusi i rekomandimit	<i>Pranuar</i>

Titulli i gjetjes: Shtesat në pagë për shoferët e autoambulancave

Nr. i Gjetjes 3	
Subjekti i audituar	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë
Subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtori i Përgjithshëm Drejtores e Financës, Investimeve dhe Buxhetit Përgjegjëse e Sektorit të Financës
Përmbledhja bazës ligjore	<p>Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;</p> <p>VKM nr. 234, datë 20.04.2022 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike, të ndryshuar, me:</p> <p>VKM nr. 627, datë 28.09.2022 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", shfuqizuar me:</p> <p>VKM nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike, të ndryshuar me:</p> <p>Vendimi nr. 422, datë 26.06.2024 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 326, datë 31.05.2023, të KM "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike";</p> <p>VKM nr. 112, datë 22.02.2006 "Për kohën e punës dhe të pushimit në</p>

Përshkrimi i gjetjeve

Situatimi i shëndetit

Situata:

me masat e kështu miratuar si përzgjedhje të kategorive 111 në 2023, shtator 2023, tetor 2023, korrik 2024 dhe Gusht 2024.

Shërbimi i urgjencës paraspitalore është i organizuar me sistem 12 orë dhe kryhet nga punonjësit me kontratë të përkohshme miratuar 15 shoferë dhe 3 shoferë pjesë e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse; gjithsej sipas planit 18 shoferë; dhe fakti 12 shoferë në Korrik 2024.

Nga auditimi rezultoi se shoferet e autoambulancave paguheshin si shoferë administrate, bazuar në VKM nr. 627, datë 28.9.2022, shfuqizuar me VKM nr/ 326, datë 31.05.2023, të ndryshuar, Kreu II/1, Lidhja II, klasa e IV.

Shtesa në pagë për orët e natës nuk është përfituar para muajit Gusht 2024, siç parashikohet në Kodin e Punës neni 87, pavarësisht se shërbimi është kryer me sistem 12 orë.

Nga verifikimi i kryer për përlllogaritjen e pagës orare nuk rezultuan gjetje. Paga orare është përlllogaritur mbi të gjithë elementët e pagës bruto siç parashikohet në VKM nr. 326, datë 31.5.2023, të ndryshuar, pika 2, në zbatim të nenit 109 të Kodit të Punës.

Përsa i përket elementëve të tjerë të pagës, kjo kategori ka përfituar:

1. Shtesë në pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin shkalla e dytë ose 4,000 lekë;

E njëjta kategori punonjësish për kryerje të shërbimit të urgjencës pranë spitaleve përfiton shkallën e dytë ose të parë dhe të dytë njëkohësisht, kjo në varësi të procedurave të kryera nga ana e spitaleve. Kjo pikë do të trajtohet në gjetjen nr. 4.

2. Shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 4,000 lekë e parashikuar në VKM nr. 326, datë 31.5.2023, ndryshuar me VKM nr. 422, datë 26.6.2024, pika 12/m.

E njëjta kategori punonjësish për kryerje të shërbimit të urgjencës pranë spitaleve përfiton shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 14,000 lekë, parashikuar në pikën 12/e, të këtyre vendimeve. Me ndryshimet e fundit pas përfundimit të auditimit kjo masë shtesë është bërë 20,000 lekë.

Kriteri:

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:

Shoferët e autoambulancave nuk kanë përfituar të njëjtët elementë page si shoferët e autoambulancave pranë spitaleve, pavarësisht se kryejnë të njëjtin shërbim.

Shënim:	Në rastin e shikuar në vëzhgimet e pagave për punonjësit mbështetës nuk është parashikuar asnjëri nga pagat e referuarat.
Vlerësimi i nivelit të riskut	Ularë
Konkluzioni	Shoferët e autoambulancave në QKUM nuk përfitojnë të njëjtët elementë page si kolegët e tyre pranë spitaleve, pavarësisht se kryejnë të njëjtin shërbim. Koncretisht: -Nuk kanë përfituar shtesë në pagë për orët e natës siç është parashikuar në Kodin e Punës, përjashtuar pagesën e kryer në muajin Gusht 2024; -Kanë përfituar më pak shtesë për natyrë të veçantë pune referuar vendimit të pagave për punonjësit mbështetës.
Rekomandimi	Për situatën më lart, vlen rekomandimi i lënë për Gjetjen nr. 2
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	<i>Lidhet me gjetjen nr. 2</i>
Statusi i rekomandimit	<i>Lidhet me gjetjen nr. 2</i>

Titulli i gjetjes: Shtesat në pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin

Nr. i Gjetjes 4	
Subjekti i audituar	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë
Subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtori i Përgjithshëm Drejtores e Financës, Investimeve dhe Buxhetit Përgjegjëse e Sektorit të Financës Përgjegjëse e Shërbimeve Mbështetëse Specialiste e Burimeve Njerëzore
Përmbledhja e bazës ligjore	VKM nr. 234, datë 20.4.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, shfuqizuar me; VKM nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Shoferët e urgjencës përfitojnë shkallën e dytë për shtesat në pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin. Sipas sqarimeve të dhëna në mënyrë verbale, miratimi i shkallës së vështirësisë i referohet vitit 2017. Kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin kanë ndryshuar me VKM nr. 234, datë 20.4.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës

	<p>Kriteri:</p> <p>VKM nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, pika 10, Lidhja III, të shfuqizuar me VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, pika 10, Lidhja III;</p> <p>Ndikimi/Efekti:</p> <p>Ndryshimi i kriterëve që nga viti 2022, reflektohet tek shkalla e vështirësi që përfitohet për punonjësit mbështetës.</p> <p>Shkaku:</p> <p>Nuk është interpretuar drejtë akti ligjor për këtë element page.</p>
<p>Vlerësimi i nivelit të riskut</p>	<p>I lartë</p>
<p>Konkluzioni</p>	<p>Elementi i pagës “shtesë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin” i referohet kriterëve të ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin, përcaktuar që në vitin 2009 me VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të shfuqizuar. Këto kriterë kanë ndryshuar në vitin 2022 me hyrjen në fuqi të VKM nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” dhe më pas të shfuqizuar me VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar.</p> <p>Pavarësisht shfuqizimit të VKM nr. 234, datë 20.04.2022, këto kriterë mbeten të njëjta dhe në aktin i cili është në fuqi VKM nr. 326, datë 31.05.2023.</p>
<p>Rekomandimi</p>	<p>Për shoferët e autoambulancave, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore, të fillojë procedurat siç parashikohet në pikën 10 të VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, për rishikimin e shtesës mbi pagë për shkallën e vështirësisë dhe të dëmshmërisë.</p> <p>Ky rekomandim vlen edhe për punonjësit e tjerë mbështetës, pasi kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin kanë ndryshuar që në vitin 2022 (trajtuar me referenca ligjore në paragrafët më lart).</p> <p>Për këtë, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore duhet të ketë</p>

Opinion i Përgjithshëm për zbatimin e rekomandimit		
Statusi i rekomandimit	i	<i>Pranuar</i>

Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:

Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore nuk ka siguruar evidencë të mjaftueshme duke shmangur në këtë mënyrë filtrat e kontrollit.

Listëprezencat në asnjë rast nuk janë shoqëruar me grafikët e shërbimit. Mungesa e këtij dokumenti nuk jep siguri nëse janë kryer kontrollet e duhura lidhur me saktësinë e të dhënave.

Gjithashtu nuk janë interpretuar drejtë vendimet e pagave lidhur me shtesat në pagë.

IV.2 Të tjera

- Probleme të ndryshme të konstatuara gjatë punës në terren.

Nga auditimi nuk u konstatuan probleme të tjera përveç atyre të trajtuara më lart.

V. Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore, për listëprezencat nuk ka siguruar evidencë të mjaftueshme e cila mundëson kryerjen e kontrolleve parandaluese dhe jep siguri për saktësinë e tyre. Gjurma e mbajtur për hartimin e listëprezencës lidhur me evidentimin e ditëve të punës nuk mundëson kryerjen e kontrolleve për mungesë të grafikëve të shërbimit si dhe mnëyrës së paraqitjes së prezencës në punë për ditët e javës dhe konkretisht për shoferët e autoambulancave.

Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore e cila është në rolin përcaktues dhe struktura përgjegjëse për financat e cila është në rolin zbatues, nuk kanë interpretuar drejtë aktet ligjore në fuqi për shtesat mbi pagë.

Shërbimi i urgjencës paraspitalore është mbuluar nga punonjës me kontratë të përkohshme miratuar me Vendim të KM dhe nga stafi i Sektorit të Njësisë së Koordinimit. Kryerja e këtij shërbimi ka ndikuar në trajtimin financiar të punonjësve, pasi në vendimet e pagave shtesat për këto kategori janë parashikuar vetëm në nivel parësor dhe spitalor. Për këtë QKUM duhet të ndjekë me prioritet rekomandimin e lënë nga auditimi i kryer në vitin 2021, rekomandim i cili vazhdon të jetë “Në proces zbatimi”.

Për të siguruar një mjedis kontrolli sa më efektiv, strukturat përgjegjëse për burimet njerëzore dhe financat, duhet të përditësohen me aktet ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin për të kuptuar rolin dhe përgjegjësitë në kryerjen e detyrave funksionale.

VI. Rekomandimet

Në përfundim të procesit të vlerësimeve të bëra nga grupi i auditimit, bazuar në germën “c” të nenit 6, dhe germën “e” të nenit 16, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, për arritjen e objektivave të Qendrës Kombëtare të

Urgjencës Mjekësore Tiranë, si dhe për të rritur efektivitetin në punën, funksionimin dhe drejtimin e këtyre institucioneve janë lënë për zbatim **4 rekomandime**

Me përputhjen e Raportit Përfundimtar është hartuar dhe Plan i Veprimit.

Plan i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit duhet të plotësohet nga Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë, sipas formatit të rekomanduar nga ana jonë dhe pasi të miratohet nga titullari të dërgohet zyrtarisht në DAB, **jo më vonë se 20 ditë pune** nga njohja me Raportin Përfundimtar.

Në rast se Qendra Kombëtare e Urgjencave Mjekësore Tiranë nuk përgjigjet me shkrim lidhur me pranimin dhe masat për zbatimin e rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara, DAB do të informojë Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për mos përmbushje të përgjegjësisë ligjore nga ana e menaxhimit të njësisë së audituar, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, neni 12/d.

Rekomandimet e lëna janë evidentuar në Planin e Veprimit, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Raporti Përfundimtar i Auditimit hartohet në tre kopje, prej të cilave një kopje i dërgohet Qendrës Kombëtare e Urgjencës Mjekësore Tiranë, një kopje ruhet në protokoll dhe një kopje ruhet në dosjen e auditimit.

Grupi i auditimit

Mimoza Kambo

Zogulla Koto



PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

Nr.	Rekomandimi	Niveli i lartë
1	<p><i>Sistemi i pagave</i></p> <p>I listëprezencat të hartohen të ndara për stafin e organikës së miratuar dhe për punonjësit me kontratë të përkohshme.</p> <p>-Për stafin e organikës të hartohet sipas sektorëve dhe shërbimeve referuar strukturës së miratuar, duke pasur parasysh nënshkrimet nga eprori direkt, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe titullari i institucionit;</p> <p>-Për punonjësit me kontratë të përkohshme të hartohet sipas sektorëve apo shërbimeve për të cilët janë kontraktuar, duke pasur parasysh nënshkrimet nga eprori direkt, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe titullari i institucionit.</p> <p>-Për shoferët e autoambulancave prezenca në punë të pasqyrohet sipas ditëve dhe shërbimit të kryer, siç është vepruar për mjekët dhe infermierët.</p> <p style="text-align: right;">Afati: Menjëherë dhe në vazhdim</p>	I lartë
2	<p>Listë prezencat në çdo rast, të shoqërohen me grafikët e shërbimit sëbashku me ndryshimet (nëse do të ketë).</p> <p>Gjithashtu listëprezencat dhe grafikët e shërbimit të jenë pjesë e dokumentacionit justifikues të listë pagesave.</p> <p style="text-align: right;">Afati: Menjëherë dhe në vazhdim</p>	I lartë
3	<p>QKUM të paraqesë situatën e krijuar pranë drejtorive përkatëse përgjegjëse për burimet njerëzore, buxhetin dhe çështjet juridike në MSHMS për të saktësuar elementët shtesë në pagë për mjekët, infermierët dhe shoferët e autoambulancave të cilët kryejnë shërbim urgjence paraspitalore, ose për të bërë rregullimet e duhura në vendimin e pagave.</p> <p>I njëjti veprim të kryhet dhe për mjekët dhe infermierët pjesë e Sektorit të Njësisë së Koordinimit, pasi nga ana e tyre kryhet shërbim me sistem 12-orë.</p> <p style="text-align: right;">Afati: Menjëherë</p>	I lartë
4	<p>Për shoferët e autoambulancave, struktura përgjegjëse për burimet njerëzore, të fillojë procedurat siç parashikohet në pikën 10 të VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, për rishikimin e shtesës mbi pagë për shkallën e vështirësisë dhe të dëmshmërisë.</p> <p>Ky rekomandim vlen edhe për punonjësit e tjerë mbështetës, pasi kriteret e ndarjes së punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin kanë ndryshuar që në vitin 2022 (trajtuar me referenca ligjore në paragrafët më lart).</p>	I lartë

Për këtë strukturë përgjegjëse për burimet njerëzore duhet të ketë parasysh përmbledhjen kur janë kryer marratimet e procedurave dhe ndryshimet e kriterëve në dispozitat tregtare.

Afati: Mungëhet

Përmbledhëse e rekomandimeve hartohet në tre kopje, prej të cilave një kopje i dërgohet Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore Tiranë, një kopje ruhet në protokoll dhe një kopje ruhet në dosjen e auditimit.

Grupi i auditimit

Mimoza Kambo

Zogulla Koto

